



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:213488

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01181506

P.nr.380/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, me gjyqtarin Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q.L nga fshati. ... Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhje Pylli nga neni 349 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.1656-11/19 të datës 23.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar jo publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit Paulin Pashku, si dhe të pandehurit, më datë 09.09.2020 mori, publikisht shpalli dhe më datë 12.10.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Q.L nga fshati. ..., Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë, nga i ati R..., dhe e ëma N... e gjinisë P..., me numër personal ..., i martuar, prind i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i gjykuar edhe më parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Më datë 15.06.2019, rreth orës 07:00, në vendin e quajtur "T...", njësia menagjuese Jasik, e cila njësi menagjohet nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar " Sh...", është hasur me qëllim vjedhje ka prerë 3 drunjë të llojit të ahut, me vëllim të përgjithshëm prej 1.34m³, të cilat i ka transportuar me t... S..., më këtë i ka shkaktuar dëm Drejtorisë së Administrimit të Parkut Kombëtar "Sharri", në vlerë prej 1.311.00€,-

Me të cilin veprim kreu veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 42, 43, 45, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 90 ditëve, ku në mbështetje të nenit 45 par 1 të KPPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme prej 240 orë (dyqind e katër dhjetë) orëve të cilin dënim do ta kryej në afat prej 3 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 45 par 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues Republikës së Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Konform nenit 45 par 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur nga 8 orë të punës për 1 ditë burgim dhe

II. Dënim me gjobë në shumën prej 300 (Tre qind) eurove, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 3 këste në afat prej 3 muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk do të mund të paguaj dënimin me gjobë, i njëjti dënim do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për çdo 20 euro 1 dite burgim. Nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës më këste do të revokohet.

III. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t'ia paguaj dëmin në shumë prej 1.311.00€

IV. Detyrohet i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësorë t'i paguajnë kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej nga 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën me PP/II.nr.1656-11/19 të datës 23.09.2019, ndaj të akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni Q.L nga fshati. ...,Komuna e Kaçanikut, i akuzuar për shkak të veprës penale "V..." nga neni 349 paragrafi 3

nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 09.09.2020,

Seanca nuk ishte publike për shkak të pandemisë Covid 19 dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK-Nr.85/2020, të datës 29 maj 2020

Në këtë shqyrtim pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, duke theksuar se kërkon nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të lehtë, është pënduar për veprën e kryer dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera apo të ngjashme penale.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht; pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si në mënyrë, datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, ka kërkuar falje dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla në të ardhmen.

Gjykata në këtë rast nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Dënimin me burgim, i cili me pëlqimin e të pandehurit iu zëvendësua me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe dënimin me gjobë gjykata e shqiptoi duke u bazuar në faktin se i pandehuri është i pa punë, ishte penduar për veprën e kryer dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, është marrë në bazë të nenit 458 par 2 të KPPK-së dhe duke u bazuar në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës nga ana e të pandehurit dhe vlerësimit të dëmit të vlerësuar nga pala e dëmtuar

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehurit që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, në t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00 € dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr. 380/19 datë 12.10.2020

Procesmbajtësja,
Suzane Rudi

Gjyqtari
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.